



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar me kërkesë të dorëzuar nga Prokurorira themelore publike ....., në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 14.12.2020, morri

### VENDIM

Denoncimi/kërkse për lajmërim e dorëzuar nga Prokuroria themelore publike ....., deri në Komisionin shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe në bazë të së cilës është formuar lënda me numër 12-3852/1 me datë 11.11.2020, **RREFUZOHET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit caktoi se është e palëndë (pa-arsyje) veprimi për lëndën me numër 12-3852/1 me datë 11.11.2020, me arsyje se bëhet fjalës për kërkesë për lajmërim, gjegjësisht nuk theksohen arsyje (gjendje) konkrete për veprime korruptive.

Lënda me numër 12-3852/1 me datë 11.11.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e KSHPK në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

### Sqarim

Lënda me numër 12-3852/1 me datë 11.11.2020 është formuar në bazë të denoncimit/kërkesës për lajmërim e dorëzuar nga Prokuroria themelore publike .....

Prokuroria themelore publike ..... kërkoi nga Komisioni shtetëror të informoj në cilat raste përshkak të realizimit të zgjedhjeve parlamentare në vitin 2020 në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka mundur të realizohet konkurs publik për drejtor në shkollë të mesme nga ana e kryeprefektit në komunën dhe nëse është ashtu për cilën periudhë kohore ka të bëjë ajo.

Me lajmërim nr. 12-3852 me datë 20.11.2020, Komisioni shtetëror e informoi Prokurorinë themelore publike ..... për:

”Në përputhje me nenin 34 paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.12/19) nga dita e publikimit të vendimit për shpallje të zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit të zgjedhjeve të kryetarit të Republikës së Maqedonisë, deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, si dhe nga dita e marrjes së vendimit për shpallje të zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit të zgjedhjeve për zgjedhje të kryetrit të komunës ose anëtarëve të këshillit, gjegjësisht deri në konstituimin e këshillit të komunave dhe të qytetit të Shkupit, nuk mund të fillohet procedura për punësim të personit të ri ose procedura për përfundim të kontratës së punës në institucione shtetërore dhe publike, kurse procedurat e filluara vëndohen në qetësi, përveç në raste për punë urgjente dhe ato që nuk mund të shtyhen.

Me marrjen e Vendimit nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 09-1422/1 me datë 16.02.2020 për shpallje të zgjedhjeve të parakohshme për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, filloi procesi zgjedhor i cili ka zgjatur deri

në 18.03.2020 kur nga ana e Kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ishte shpallur gjendje e jashtëzakonshme përshkak të gjendjes së shkaktuar nga kriza e Covid-19. Në përputhje me kompetencat në gjendje të jashtëzakonshme, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me datë 21.03.2020 miratoi Dekret me fuqi të Ligjit për çështje lidhur me procesin zgjedhor nr. 44-2413/1 ku rregullohet se nga dita e miratimit të dekretit dhe deri në ditën e mbarimit të gjendje së jashtëzakonshme përfundojnë të gjitha aktivitetet zgjedhore për realizim e zgjedhjeve për deputetë. Gjithashtu, në nenet 7 dhe 8 nga Dekreti është theksuar se nga dita e zbatimit të Dekretit dhe deri në ditën e përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme nuk zbatohen nenet 8-a, 75-g, 75-d, 84-a nga Kodi zgjedhor, si dhe neni 34 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, gjendje e jashtëzakonshme ishte shpallur disa herë, kurse mbaroi me datë 13.06.2020.

Gjithashtu, duhet të merret parasyshë përfundimet e miratuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedinisë së Veriut në vazhdimin e senacës së tredhjetë e dytë të mbajtur me datë 01 prill 2020, në lidhje me paragrafin 59- "Informacion për zvogëlim të shpenzimeve joproductive përshkak të përballimit me sfidat e krizëz shëndetësore – ekonomike të shkaktuara nga virusi Covid-19". Me Përfundim, në sektorin publik përkohësisht ndalohen punësime të reja, angazhimet të reja nëpërmjet agjensioneve për punësime të përkohshme, dhe kontrata të reja në vepër, përveç për angazhim të kuadrit adekuat në sektorin shëndetësor dhe në sektoret tjera të cilët janë në drejtim të përballimit me pasojat nga Virusi korona. Gjithashtu, me Përfundim obligohen të gjithë shfrytëzuesit e buxhetit që deri në fund të viti 2020 t'i respektojnë masat për zvogëlim të shpenzimeve".

Në bazë të të gjitha rrethanave në lëndën, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, konstaton se është e palëndë (pabazë) veprimi për të njëjtin, me arsye që bëhet fjalë për kërkesë për lajmërim, gjegjësisht nuk theksohen akuza konkrete për veprime korruptive.

Duke pasë parasyshë të theksuarën më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 12/19) vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Pas përfundimit të KSHPK

Punopi: m-r B. K. SH., këshilltarë

Miratoi: m-r SH. S., anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËROР ПËР  
PARANDALIM ТË KORRUPTIONIT  
Kyetar: Biljana Ivanovska